

KONTEJA MACOMB

UDHËZUES MBI PARAPËRGATITJEN PËR EMERGJENCAT



MANUAL & UDHËZIME

Komunikimet & Menaxhimi i Emergjencave • (586) 469-5270 • mcoem.macombgov.org

PËRMBAJTJA

Mesazh nga Ekzekutivi i Kontesë Macomb.....	4
Hyrje në Menaxhimin e Emergjencave.....	5
Pyetësor për Parapërgatitjen Familjare.....	7
Kërkimi i Rreziqeve të Shtëpisë.....	8
Çfarë mund të bësh që të përgatitesh.....	11
Përgatit një Kuti Rezervash për Emergjenca.....	13
Një Kuti Evakuimi për shtëpinë tënde.....	14
Një Kuti Fatkeqësish për Makinën tënde.....	15
Plani i Komunikimeve për Rastet e Emergjencave.....	16
Kontaktet Telefonike për Rastet e Emergjencave.....	17
Numrat e Telefonit për Rastet e Emergjencave.....	18
Informacionet mbi Kujdestaret e Fëmijëve.....	19
Sistemet e Paralajmërimit Jashtë Shtëpisë.....	21
Evakuimi dhe Strehimi-në-Vend.....	23
Kur Ndodh një Rast Emergjence.....	25
Jini në Gatishmëri! Përmbytjet.....	27
Rikuperimi nga një Fatkeqësi/Emergjencë.....	28
Terrorizmi.....	31
8 Shenja të Terrorizmit.....	32
Parapërgatitja për një Sulm Terrorist.....	33
Sulmuesit Aktivë.....	35
T'i Telefonosh Numrit 9-1-1.....	37



MESAZH NGA EKZEKUTIVI I KONTESE



Jam i lumtur të prezantoj këtë Manual për Parapërgatitjen e Komunitetit në rast Emergjencash, i cili do t'ju vijë në ndihmë njerëzve që jetojnë dhe punojnë në Kontenë Macomb për t'u parapërgatitur për raste fatkeqësish natyrore ose të shkaktuara nga njeriu. Pasja e një plani të parapërgatitur kur ndodh një emergjencë u mundëson të prekurve që të reagojnë në mënyrë të sigurt dhe të efektshme. Planifikimi përpara një emergjence krijon një komunitet më të fortë dhe i mundëson personelit tonë të përkushtuar të shërbimeve të emergjencës t'i kryejë detyrat e tij duke e ditur se komunitetet të cilave u shërben janë të përgatitur për t'i ndihmuar.

Ju lutem të merrni pak minuta për t'i diskutuar këto udhëzime me familjarët, miqtë dhe kolegët tuaj; vetëm një sasi e vogël parapërgatitjeje mund t'ju ndihmojë të shpëtoni në rast emergjence. Shpresoj që ta mbani këtë udhëzues si një mjet të cilit mund t'i referoheni me shpejtësi dhe t'i shfrytëzoni shumë prej sugjerimeve brenda tij në shtëpinë apo vendin tuaj të punës. Nëse doni informacione shtesë lidhur me planifikimin për emergjencat, ju lutem kontaktoni me Komunikimet dhe Menaxhimi i Emergjencave - Konteja Macomb në (586) 469-5270 ose mcoem@macombgov.org

I juaji sinqerisht,

Mark A. Hackel

Informacioni në këtë udhëzues është mbledhur nga publikime të ndryshme të ofruara nga Kryqi i Kuq Amerikan, Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve (CDC), Agjencia Federale e Menaxhimit të Emergjencave (FEMA), dhe Departamenti i Sigurisë (DHS) për t'ju ndihmuar në parapërgatitjen për lloje të ndryshme fatkeqësish.





HYRJE
NË MENAXHIMIN
E EMERGJENCAVE

HYRJE NË MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE

Sipas Aktit Publik 390 të vitit 1976, i ndryshuar, Konteja Macomb ka krijuar një program të menaxhimit të emergjencave i cili ka për detyrë koordinimin e veprimtarive të parandalimit, parapërgatitjes, përgjigjes, rikuperimit dhe lehtësimit para, gjatë, dhe pas emergjencave dhe fatkeqësive në mbarë kontenë. Drejtori i Menaxhimit të Emergjencave caktohet nga Ekzekutivi i Kontesë, dhe është përgjegjës për standardet dhe kërkesat e programit, të themeluara nga Divizioni i Policisë Shtetërore të Michigan për Menaxhimin e Emergjencave dhe Sigurinë e Atdheut.

Ky manual është krijuar për t'i ndihmuar komunitetet tona që të parapërgatiten për një fatkeqësi apo emergjencë. Ai jep informacione lidhur me rreziqet e njohura me të cilat mund të përballeni në Kontenë Macomb. Ndonëse mund të jetë e vështirë ta mendoni ndodhjen e një fatkeqësie ndaj njerëzve të afërt, duke marrë kohën e nevojshme për t'i shqyrtuar këto informacione, ju do të jeni më të përgatitur për të marrë masa të shpejta për të mbrojtur veten, familjen dhe pronën tuaj gjatë një rasti emergjence.

Konteja Macomb ka ndërmarrë hapat e mëposhtëm për t'u përgatitur për një rast emergjence apo fatkeqësie:

- Një Drejtor i Menaxhimit të Emergjencave është caktuar për të koordinuar të gjitha veprimtaritë e parandalimit, parapërgatitjes, përgjigjes, rikuperimit dhe lehtësimit të emergjencave apo fatkeqësive brenda Kontesë Macomb.

- Është krijuar një sistem planesh, protokolle, dhe udhëzimesh për emergjencat, sistem i cili përshkruan konceptet e përgjithshme të operacioneve që do të kryhen gjatë një fatkeqësie apo emergjence. Këto përfshijnë planet për Kontenë si dhe juridiksionet, shkollat, spitalet, dhe bizneset lokale.
- Një staf i operacioneve të emergjencave që përbëhet nga punonjës të sektorit privat dhe publik si dhe vullnetarë me njohuri të veçanta lidhur me funksionet që kryhen gjatë një rasti emergjence është identifikuar dhe trajnuar.
- Një Qendër e Operacioneve të Emergjencës është themeluar brenda Qendrës së Komunikimeve dhe Teknologjisë të Kontesë Macomb (COMTEC) për të siguruar koordinimin e të gjitha veprimtarive e burimeve të përgjigjes ndaj emergjencave në konte. COMTEC është një kompleks modern që ofron informim mbi situatën 24/7 për banorët tanë, bizneset dhe reaguesit e parë. Kjo përfshin një mur të projektimit të videove me përmasa 20' x 50', stacione të monitorimit të trafikut, stacione nisjeje, dhe stacione të operacioneve të emergjencave.



MACOMB COUNTY
COMTEC
Communications & Technology
Center

PYETËSORI I PARAPËRGATITJES FAMILJARE

Para se ta eksploroni këtë udhëzues, ju lutem përgjigjuni pyetësorit të mëposhtëm për të matur se sa dijeni keni aktualisht lidhur me parapërgatitjen bazë për emergjencat. Të gjitha temat e përmendura më poshtë do të trajtohen më thellësisht gjatë këtij udhëzuesi, kështu që nëse do të donit të mësonit më shumë, ju lutem ktheni faqen dhe vazhdoni të lexoni.

- 1. A i dini rreziqet që mund të hasni në shtëpinë dhe komunitetin tuaj?**
- 2. A besoni se komuniteti juaj është i përgatitur për emergjencat?**
- 3. A besoni se familja juaj është e përgatitur mirë për t'u përballur me shumicën e emergjencave?**
- 4. A i keni diskutuar me familjen tuaj çështjet e planifikimit për emergjencat?**
- 5. A keni një kuti familjare rezervash për rastet e emergjencave, e cila të përfshijë:**
 - Një rezervë tre-ditore uji për person (një gallon për person, në ditë)
 - Një rezervë tre-ditore ushqimesh të konservuara
 - Një palë rroba për person për t'u ndërruar
 - Një batanije ose çantë fjetjeje për person
 - Kutitë e ndihmës së shpejtë me ilaçet që i merrni aktualisht me recetë (mjaftueshëm për katër ditë)
 - Radio & elektrik dore me bateri, plus bateri shtesë
 - Kopje shtesë çelësash makine
 - Një kartë krediti dhe një sasi të vogël parash kesh
 - Mjete higjiene
 - Rezerva të nevojshme për kafshët shtëpiake
- 6. A keni në shtëpi detektorë tymi në çdo nivel?**
- 7. A keni një fikëse zjarri ABC të karikuar?**
- 8. A e keni trajnuar familjen tuaj mbi përdorimin e duhur të një fikëseje zjarri?**
- 9. A dini si t'i stakoni furnizimet e shtëpisë (ujin, elektricitetin, gazin, etj.)?**

GJUETIA E RREZIQEVE TË SHTËPISË

Një hap i rëndësishëm në parapërgatitjen familjare është identifikimi i rreziqeve në shtëpinë tuaj. Tani që e keni plotësuar pyetësonin, ju lutem kryeni edhe një kërkim të rreziqeve të shtëpisë.

Lista e mëposhtme thekson disa zona që mund të paraqesin rrezik - dhe kjo përfshin çdo gjë që mund të lëvizë, të thyhet, të rrëzohet apo të digjet. Përgjigjuni po ose jo në secilën kategori bazuar në përjashtjen tuaj aktuale ndaj këtyre zonave. Për shembull, nën seksionin e kuzhinës, ju bëhet pyetja nëse vishni rroba të ngushta në trup kur gatvani. Ju lutem shënoni po nëse vishni rroba të tilla dhe jo nëse nuk i vishni. Kur ta mbaroni këtë gjueti duke iu përgjigjur të gjitha pyetjeve, mund të vazhdoni ta lexoni udhëzuesin dhe më pas të krijoni një plan për t'i reduktuar apo eliminuar të gjitha rreziqet brenda shtëpisë suaj. Largpamësia, imagjinata dhe sensi praktik janë të vetmet vegla që do ju duhen.

KUZHINA

Po Jo

- Vishni rroba të ngushta në trup kur gatvani
- Nuk e lini pa kontrolluar një ushqim që po gatuhet
- I mbani bishtat e tiganëve të kthyer nga brenda ndërkohë që gatvani
- Mbani një kapak tiganit pranë për çdo rast zjarri
- I mbani zonat e gatimit të pastra dhe i hiqni sendet që mund të marrin flakë
- Nuk i lini telat të varur
- Siguroheni që prizat pranë lavamanit të kuzhinës të jenë të pajisura me GFI (me tokëzim)
- I mbani thikat e mprehta në vende ku fëmijët nuk mund t'i arrijnë

JASHTË

Po Jo

- I hiqni bimët e thara dhe mbeturinat nga zona përreth shtëpisë
- I përdorni zgarat e gatimit larg ndërtesave dhe bimësisë
- I hidhni briketat e zgarave të barbekjës në një enë metali
- Mbani një "rrip të gjelbër" përreth ndërtesave rurale
- Konsultoheni me departamentin e zjarrit para se të digjni mbeturina apo të përdorni një fuçi për djegie

Të GJITHA DHOMAT

Po Jo

- Siguroheni që mbulesat e dyshemeve (qilimat, tapetët) të jenë të siguruara siç duhet për të parandaluar ndonjë rrezik rrëzimi
- I ndani nga njëri-tjetri litarët që shërbejnë për tërheqjen e grilave dhe perdeve për të zvogëluar rreziqet e mbytjes së fëmijëve
- Siguroheni që daljet nga dhomat të jenë pa pengesa

GARAZHI/PAPAFINGO/HANGARI

Po Jo

- E përdorni gazolinën vetëm si lëndë djegëse për motor dhe nuk e mbani kurrë brenda shtëpisë
- Mbani vetëm një sasi të vogël gazoline, nëse është e nevojshme, në një kontenier të kyçur
- I mbani lëngjet që mund të marrin flakë, si bojërat dhe lëndët holluese, në enët e veta

origjinale dhe i ruani mbi ose pranë tokës dhe larg burimeve të nxehtësisë, shkëndijave apo flakës

PIRJA E DUHANIT & SHKREPËSET

Po Jo

- I mbani shkrepëset dhe çakmakët në vende ku fëmijët nuk mund t'i arrijnë
- Përdorni tavëlla të gjera, të thella, që nuk derdhen
- Nuk pini kurrë duhan kur jeni të përgjumur ose në shtrat
- E hidhni hirin dhe bishtat e cigareve në një kuti metali të paktën çdo ditë
- I kontrolloni çdo natë mobilet mos ka ndonjë cigare që vazhdon të digjet, sidomos pas një feste

ELEKTRICITETI

Po Jo

- I shmangeni përdorimit të zgjatuesve elektrikë (nëse i përdorni, siguroni parametrat e duhur në shkallën vat)
- Vini vetëm një pajisje nxehtësie në një prizë elektrike
- Siguroheni që telat të mos jenë nën qilima
- Verifikoni që qarqet elektrike të mos jenë të mbingarkuara
- I zëvendësoni telat, spinat, prizat e dëmtuara
- Përdorni poça me parametrat e duhur në vat për llambat dhe dritat
- I kontrolloni siguresat/ndërprerësit e qarkut që të kenë parametrat e duhur në amper
- Nuk i tejkaloni ose anashkaloni siguresat ose ndërprerësit e qarkut

RROBAT / LAVATRIÇJA & THARËSJA

Po Jo

- Verifikoni që pajisjet të jenë të tokëzuara mirë
- Siguroheni që filtri të jetë i pastër dhe funksional
- Kontrolloni tubin e ventilimit dhe linjën e ventilimit që të siguroheni që janë të pastra dhe ajri kalon lirshëm përmes tyre

FIKËSJA E ZJARRIT

Po Jo

- Verifikoni që keni një fikëse zjarri universale (Klasa ABC) në një vend të aksesueshëm
- Siguroheni që të gjithë banorët e shtëpisë dinë si



- ta përdorin
- A ka fikëse zjarri shtesë që mbahen në kuzhinë, garazh, bodrum, dhe në zonën e fjetjes?
- I mbani leckat e përdorura e me vaj në kontenierë të mbyllur metali
- Nuk i magazinoni kurrë sendet që mund të marrin flakë, si gazetatat dhe revistat

PAJISJET E NGROHJES

Po Jo

- Siguroheni që vatrat e zjarrit dhe sobat me gaz/dru t'i zbatojnë kodet lokale
- E pastroni dhe e kontrolloni oxhakun çdo vit
- E hidhni hirin në kontenierë metali
- I mbani veshjet, orenditë dhe telat elektrikë të paktën 12 inç nga ngrohësit e murit dhe 36 inç nga ngrohësit portativë
- I bëni shërbim kaldajës çdo vit
- E vendosni termostatin e ngrohësit të ujit në 120 gradë F
- I vendosni ngrohësit me gaz të ujit, të rinj apo zëvendësues, në një lartësi të paktën 18 inç sipër dyshemesë

BANJAT

Po Jo

- I mbani produktet e pastrimit dhe medikamentet që janë helmuese në vende "që nuk preken nga fëmijët"
- I zëvendësoni shishet e qelqit me shishe plastike
- Siguroheni që të gjitha prizat të jenë të pajisura me GFI

PARAPËRGATITJA FAMILJARE

Po Jo

- Planifikoni dy dalje të papenguara nga të gjitha dhomat, duke përfshirë katin e dytë, dhe siguroheni që të gjithë t'i dinë ato
- Përcaktoni një vend takimi jashtë
- Keni një kontakt jashtë shteti për familjen pas një fatkeqësie/emergjence

- Zhvilloni një plan shpëtimi dhe e praktikoni atë rregullisht
- I ruani dokumentet e rëndësishme dhe gjërat me vlerë në një kasafortë apo kabinet të mbrojtur nga zjarri
- Mbani siguracionin dhe mbulimin e duhur për shtëpinë tuaj dhe sendet brenda saj (siguracion tërmeti, përmblytjeje, qiradhënësi, zjarri)

DETEKTORËT E TYMIT & CO2

Po Jo

- I instaloni si duhet në çdo nivel
- I testoni të martën e parë të çdo muaji
- I zëvendësoni bateritë çdo gjashtë muaj

Të GJITHA RREZIQET (KONSIDERATA TË TJERA)

Po Jo

- I gozhdoni mobilitet e rënda e të larta tek drurët mbështetës të murit
- I siguroni kabinetet e kuzhinës dhe banjës me shul "pozitiv" (që mbyllet vetë)
- I mbani sendet e rënda dhe/ose të thyeshme në raftet e poshtme
- I kontrolloni themelet mos kanë çarje dhe i riparoni sipas nevojës
- I siguroni pasqyrat dhe fotot që të rrinë mirë për mur ose i varni ato me tela të rëndë, të futur në vida me lak ose varëse të puthitura mirë
- I përdorni siç duhet pajisjet e heqjes së dëborës (lopatat dhe/ose makinat për largimin e borës)
- I përgatisni automjetet për motin e dimrit (frenat, sistemin elektrik, motorin, ndërrimin e naftës, dritat, gomat e makinës)
- Vishni këpucë të përshtatshme kur ecni mbi borë dhe mbi akull për të reduktuar rrëshqitjet.
- Hidhni kripë nëpër vendet e kalimit për t'i hequr akullin dhe borën nga zonat që mund të jenë rrëshqitëse.
- Identifikoni një strehë emergjence në shtëpinë tuaj

Stërvitjet praktike janë një mënyrë shumë e mirë për ta ndihmuar familjen që të planifikojë e të mbajë mend çfarë duhet bërë në rast fatkeqësie apo emergjence.

STËRVITJET PËR RASTE ZJARRI

Çdo pjesëtar i familjes duhet të zvarritet jashtë shtëpisë për t'u takuar në një pikë takimi pasi të dalin jashtë. Dhe do të ishte mirë të kishit një vend të butë në lëndinë për të praktikuar rotullimin në tokë për rastet kur marrin flakë rrobat. Ndërkohë, sigurohuni që të gjitha alarmet e tymit dhe monoksidit të karbonit të kenë bateri të reja, fikësja e zjarrit të jetë e karikuar, dhe shtigjet e ndryshme të arratisjes të jenë të lira.

EMERGJENCAT MJEKËSORE

Të praktikohet familja për t'u kujdesur për një pjesëtar "të plagosur". Nëse keni në familje pjesëtarë adoleshentë apo në moshë shkollorë, ju mund t'i thoni atyre të kryejnë ndihmën e parë ndaj një prindi. Thuajini që keni prerje të thella dhe gjendje të fikti. Sigurohuni që ata ta dinë se ku ndodhen pajisjet mjekësore dhe lejojini të praktikohen në përdorimin e tyre. Për fëmijët më të vegjël apo më të ndjeshëm, mund ta bëni praktikën pak realiste duke imituar një prerje të thellë me një vijë të kuqe në krah, të vizatuar me shenjues. Më pas kërkojini që t'jua lidhin plagën.



**ÇFARË MUND
TË BËNI
PËR T'U PËRGATITUR**

ÇFARË MUND TË BËNI PËR T'U PËRGATITUR

Të kuptuarit e rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozoheni ju dhe familja juaj është një hap i rëndësishëm në planifikimin për emergjencat. Lista që vijon identifikon rreziqet që mund të ndodhin në Michigan-in Jug-lindor. Meqë jetojmë, punojmë, shkojmë në shkollë dhe luajmë në zonën tonë, duhet të jemi të vetëdijshëm për atë çfarë mund të ndodhë përreth nesh. është e rëndësishme t'i diskutoni me familjen tuaj rreziqet e mundshme në mënyrë që të mund të filloni të përgatisni Planin tuaj për Emergjencat.

Stuhitë Dimërore	Erëra të Forta/Tornado	Shtrëngatat/Breshëri
Incidentet e Materialeve të Rrezikshme	Përmbytjet	Zjarret e Ndërtesave
Dështimi i Infrastrukturës	Thatësira	Emergjencat e Shëndetit Publik
Temperaturat Ekstreme	Trazirat Civile	Zjarret në pyje
Ndërprerja e Energjisë Elektrike	Terrorizmi/Sabotimi	Sulmuesit Aktivë

FUSHAT E MISIONIT TË PARAPËRGATITJES KOMBËTARE

Parandalimi

Parandalimi, shmangia apo ndalimi i një akti të afërt, të paralajmëruar apo aktual terrorizmi.

Mbrojtja

T'i mbrojmë qytetarët, banorët, vizitorët, dhe asetet tona ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve më të mëdha në mënyrë që t'i lejojë të lulëzojnë interesat, aspiratat dhe mënyra jonë e jetesës.

Zbutja

Reduktimi i humbjes së jetës dhe pasurisë duke e zbutur impaktin e fatkeqësive të ardhshme.

Përgjigjja

Të përgjigjemi shpejt për të shpëtuar jetë, mbrojtur pasuritë dhe mjedisin, dhe për të plotësuar nevojat njerëzore bazë pas një incidenti katastrofik.

Rikuperimi

Rikuperimi përmes fokusimit në restaurimin, forcimin dhe rigjallërimin e shpejtë të infrastrukturës, strehimit dhe të një ekonomie të qëndrueshme, si dhe të strukturës shëndetësore, shoqërore, kulturore, historike dhe mjedisore të komuniteteve të prekura nga një incident katastrofik.

PËRGATITNI NJË KUTI REZERVASH PËR EMERGJENCA

Duhet të bëni gati paraprakisht ujë, ushqim, mjete të ndihmës së shpejtë, veshje, mbulesa fjetjeje, vegla e sende të tjera të domosdoshme dhe të jeni të përgatitur në rast se duhet të evakuoheni apo të mbeteni pa elektricitet, ngrohje, apo ujë për një periudhë të gjatë. Këto rezerva mund të vendosen në kova 5-gallonëshe, çanta kampingu apo çanta shpine.

Konsiderojini gjërat e mëposhtme për t'i përfshirë në një kuti rezervash për emergjencë:

UJË

(Rezerva për tre ditë - një gallon për person në ditë)

- Ruajeni ujin në kontenierë të mbyllur mirë e të pathyeshëm (Zëvendësojeni çdo gjashtë muaj)

USHQIM

(Rezerva ushqimi të konservuar, për tre deri në pesë ditë për person)

- Ushqime (me shumë kalori, të gatshme për t'u ngrënë)
- Qumësht/lëngje (në kanaçe ose në formë pluhuri)
- Mish të tymosur ose të tharë (të prerë hollë dhe të tharë)
- Multivitamina, fibra, kripë
- Komplet enësh metali (për gatim/ngrënie)
- Gota, pjata & mjete plastike ngrënieje
- Hapëse kanaçesh (manuale)
- Mjete gatimi/vegla kuzhine, takëme
- Letër alumini
- Sapun, detergjent të lëngshëm, lëngje për larje, tel enësh, shishe spërkatëse
- Qese frigoriferi (në madhësi të ndryshme)

PASTËRTIA

- Mjetet e higjienës personale
- Qese plastike plehrash & lidhëse
- Kovë plastike me kapak që mbyllet mirë
- Dizinfektues me spërkatje
- Pece ose letra të lagura
- Letër higjienike tualeti

VESHJE & MBULESA FJETJEJE

(Një komplet i plotë veshjesh & këpucësh për person)

- Këpucë të forta ose çizme pune
- Veshje shiu

- Batanije ose çanta fjetjeje
- Kapuçë, doreza, rroba të ngrohta & të brendshme termale
- Kapele, krem dielli, syze dielli

KUTIA E NDIHMËS SË SHPEJTË

(Në një kontenier që nuk laget nga uji)

- Fasha sterile adezive
- Garza sterile 2 & 3 inç
- Fasha trekëndëshe
- Shirit adeziv hipoalergjen
- Rrotulla fashash sterile 2 & 3"
- Gërshërë & pinceta
- Gjilpëra & brisqe të sigurta
- Sapun & spërkatës antiseptik
- Peceta të lagura
- Pikatore ilaçesh
- Termometër i pathyeshëm
- Doreza lateks
- Maskë pluhuri
- Vazelinë
- Madhësi të ndryshme paramanash
- Depresor gjuhe & shkopinjë të drunjtë aplikatorë
- Tableta për pastrimin e ujit

VEGJA & PAJISJE

- Elektrik dore me bateri shtesë dhe llamba shtesë
- Radio që punon me bateri, plus bateri shtesë
- Shkrepëse në një kuti që nuk laget nga uji
- Çakmak, Dritë Sinjalizuese, Fikëse Zjarr
- Lopatë që paloset
- Vegël me funksion të shumëfishtë
- Thikë e palosshme
- Letra, Lapsa, Gërshërë, Ngjitës
- Harta (të Qytetit, Kontesë, Shtetit)
- Para (Kesh dhe Kartë Krediti)
- Shirit ngjitës

SENDE TË VEÇANTA

Për bebet:

- Qumësht formule, lëng & pluhur
- Pelena & peceta
- Shishe & ilaçe

Për të rriturit:

- Ilaçe/insulinë
- Sendet për kujdesin ndaj protezave të dhëmbëve
- Lente kontakti & syze shtesë
- Argëtim - lojëra, libra
- Celularë

Për kafshët shtëpiake:

- Ushqim & Ujë
- Qafore & rrip
- Mbajtësen e kafshës/kafazin
- Dokumentet

DOKUMENTET

(Në një vend që nuk laget nga uji)

- Manuali i përgatitjes për emergjencë
- Numra të rëndësishëm telefoni
- Testamente, polica sigurimi
- Kontrata, dokumente ligjore, dokumente aksionesh & obligacione
- Pasaporta, karta të sigurimeve shoqërore
- Dokumentet e imunizimit
- Dokumentet familjare (çertifikata lindjeje, martesë, vdekjeje)
- Inventar i sendeve të çmuara të shtëpisë
- Dokumente financiare (llogari bankare, llogaritë e kartave të kreditit)
- Lejet (për gjueti/peshkim/zjarr)

NJË KUTI EVAKUIMI PËR SHTËPINË TËNDE

Një zjarr, përmytje apo tjetër rast emergjence mund të kërkojë evakuim të menjëhershëm të shtëpisë. Sendet e mëposhtme duhet të mbliidhen dhe të vendosen në një kontenier të vogël e portativ, në një vend lehtësisht të aksesueshëm në mënyrë që të mund ta merrni kollaj teksa dilni nga shtëpia.

Konsideroni përfshirjen e sendeve të mëposhtme në një kuti evakuimi për shtëpinë tuaj:

- 2x Shishe Uji
- Ushqime me energji të lartë, që nuk prishen (granola, arrore në kanaçe, karamelë të forta, miks frutash të thata, gjalp kikiriku & biskota krokante)
- Një radio e vogël që punon me bateri (preferohet AM) dhe bateri shtesë
- Kutit e vogël e ndihmës së shpejtë
- Elektrik dore me bateri shtesë
- Një sasi e vogël parash dhe monedhash, si dhe një kartë krediti (në një vend që nuk laget nga uji)
- Një kopje shtesë çelësash të makinës dhe shtëpisë
- Dokumente thelbësore të familjes në një kontenier portativ e të mbrojtur nga zjarri
 - Kartat e Sigurimeve Shoqërore
 - Polica sigurimi
 - Testamente
 - Dokumente ligjore
 - Numrat e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit
 - Çertifikata lindjeje dhe martesë
 - Inventar i sendeve shtëpiake dhe gjërave të çmueshme/aseteve (videot e sendeve shtëpiake ose fotot janë jashtëzakonisht të dobishme)
- Një palë syze shtesë
- Plan evakuimi (numrat e kontakteve, vendi i takimit)
- Sendet e nevojshme për kafshët shtëpiake



NJË KUTI FATKEQËSISH PËR MAKINËN TËNDE

Mbajeni makinën të pajisur me rezerva për raste emergjencash. Duhet të jeni në dijeni të niveleve në serboratorin e makinës dhe nëse jepen paralajmërime për ndonjë emergjencë të afërt, mbusheni atë. Stacionet e karburantit mund të jenë prekur nga emergjenca dhe mund të mos jenë të disponueshme. Mbajini këto sende në një kontenier portativ.

Konsideroni përfshirjen e sendeve të mëposhtme në një kuti fatkeqësish për makinën tuaj:

- 2x Shishe Uji
- Ushqime me energji të lartë, që nuk prishen (granola, arroje në kanaçe, karamelë të forta, miks frutash të thata, gjalp kikiriku & biskota krokante)
- Elektrik dore me bateri shtesë
- Kuti të Ndhmës së Shpejtë
- Kabllo për lidhje me baterinë e një makine tjetër
- Mjete për riparimin e gomave të makinës dhe pompë
- Trekëndësha reflektivë dhe jelek sigurie
- Fikëse Zjarri
- Mushama shiu
- Karikues portativ makine
- Harta lokale
- Vegël me funksion të shumëfishtë
- Drita sinjalizuese
- Batanije

Për mot të ftohtë përfshini:

- Batanije
- Fshirëse dëbore/ furçë
- Lopatë
- Veshje të ngrohta
- Baltë macesh (për tërheqje)



KRIJONI NJË PLAN KOMUNIKIMI PËR EMERGJENCAT

Familja juaj do të mund ta përballojë më mirë një emergjencë nëse përgatitet për të para se të ndodhë. Dijenia se ku ndodhet çdo pjesëtar i familjes shërben për të krijuar qetësi në mendjen tuaj, qoftë për një pjesëtar të rrethit të ngushtë familjar, qoftë për një të afërm të prekur nga një fatkeqësi jashtë shtetit. Të pasurit e një plani komunikimi do t'ju ndihmojë të mbani kontakt me të gjithë familjen tuaj. Ndiqni këto hapa të thjeshtë për të patur një mendje të qetë.

- Zgjidhni një kontakt jashtë qytetit të cilin familjarët tuaj mund ta telefonojnë në rast fatkeqësie.
- Sigurohuni që secili prej pjesëtarëve të familjes t'i dijë këto numra telefoni. Krijoni një kartë të vogël kontaktesh që mund ta mbajnë për t'iu referuar lehtësisht.
- Testojeni kontaktin jashtë qytetit rregullisht. Gjithashtu, thuajini edhe atij personi që t'ju telefonojë.
- Jepjani numrat e kontaktit për emergjenca zyrtarëve në shkollën e fëmijës suaj.

KUJTOHUNI TË NDIHMONI TË TJERËT

Mund të ketë banorë të moshuar ose invalidë që jetojnë në lagjen tuaj, të cilët kanë nevojë për ndihmë gjatë një emergjence.

Përfshijini ata në listën e komunikimeve tuaja që të kujtoheni t'ua komunikoni gatishmërinë tuaj për t'i ndihmuar në rast fatkeqësie.

- Bëni një listë të fqinjëve që mund të kenë nevojë për ndihmë shtesë.
- Kërkojani numrat e telefonit dhe adresat, vetëm nëse ata nuk e kanë problem t'ju japin.
- Në rast emergjence, kontaktojini këta fqinjë dhe sigurohuni që t'u plotësohen nevojat.
- Ndhimojini që të identifikojnë edhe ata një kontakt jashtë qyteti për vete.



Në rast fatkeqësie, gjithmonë telefonojini numrit 9-1-1 për shërbim emergjence. Mos e përdorni 9-1-1 për të bërë pyetje, për të mësuar ndonjë informacion apo për të kërkuar ndihmë jo-emergjente. Gjatë një fatkeqësie, agjentët e emergjencës janë zakonisht të mbytur nga telefonatat për ndihmë. Sigurohuni që telefonata juaj është e llojit të një emergjence. Kjo do të garantojë që t'u jepet ndihma njerëzve që kanë vërtet nevojë për të.

Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim që nuk është i llojit të një emergjence, telefonojini numrit të punës të qeverisë suaj lokale ose numrit të lidhjeve direkte të dhënë nga stacionet lokale të televizionit, radios, ose të lajmeve.

Mësojuni fëmijëve tuaj si të bëjnë një telefonatë emergjence, duke theksuar gjithmonë rëndësinë e faktit që 9-1-1 duhet marrë vetëm për emergjenca.

NUMRAT E TELEFONIT PËR EMERGJENCA

Policia.....	FORMONI NUMRIN 911
Zjarrfikësja.....	FORMONI 911
Ambulanca.....	FORMONI 911
Sherifi i Kontesë.....	586-469-5151
Menaxhimi i Emergjencave të Kontesë.....	586-469-5270
Departamenti i Shëndetit i Kontesë.....	586-469-5235
Punët Publike të Kontesë.....	586-469-5325
Departamenti i Rrugëve i Kontesë.....	586-463-8671
Policia Shtetërore e Michigan (Richmond Post).....	586-727-0200
FBI (Zyra në Detroit).....	313-965-2323
Qendra Kombëtare e Përgjigjeve për Derdhje Nafte/Kimike....	800-424-8802
Shërbimet Amerikane të Emergjencës të Rojave Bregdetare..	800-321-4400
Dogana dhe Mbrojtja e Kufirit (CBP).....	800-232-5378
Imigracioni dhe Zbatimi i Ligjit në Doganë (ICE).....	313-568-6042
Qendra e Michigan për Kontrollin e Helmeve.....	800-222-1222
Kryqi i Kuq Amerikan S.E MI (Shpëtimi në Rast Fatkeqësie)....	313-833-8816
Ushtria e Shpëtimit (Shërbimet për Fatkeqësitë).....	888-803-8858
DTE Energy.....	800-477-4747
Consumers Energy.....	800-477-5050

KONTAKTET TELEFONIKE PËR RASTE EMERGJENCASH

KONTAKT LOKAL

Emri _____
Qyteti _____
Telefoni _____

KONTAKT JASHTË ZONËS

Emri _____
Qyteti _____
Telefoni _____

I AFËRMI MË I AFËRT

Emri _____
Qyteti _____
Telefoni _____

NUMRAT E PUNËS TË FAMILJES

Babai _____
Nëna _____
Të tjerë _____

NUMRAT E TELEFONIT PËR EMERGJENCA

Departamenti i Policisë _____
Departamenti i Zjarrit _____
Spitali _____

MJEKËT E FAMILJES

Emri _____ Telefoni _____
Emri _____ Telefoni _____
Emri _____ Telefoni _____

VENDET E RIBASHKIMIT

Pranë shtëpisë _____
Larg shtëpisë, në rast se nuk mund të ktheheni _____
Adresa _____
Telefoni _____
Rruga që do të provohet e para _____

SHËRBIMET

Elektriciteti _____
Gazi _____
Uji _____



INFORMACION PËR KUJDESTAREN E FËMIJËVE

Shpesh përdorim kujdestare fëmijësh. Qofshin ato njerëz nga familja jonë apo të rekrutuara nga komuniteti, ato mund të mos jenë në dijeni të planeve dhe kontakteve të shtëpisë sonë për rastet e emergjencave. Kur ia besojmë të tjerëve kujdesin për shtëpinë tonë dhe njerëzit që duam, është pa dyshim e nevojshme që të gjithë njerëzit e përfshirë të dinë si t'i trajtojnë emergjencat kur ndodhin.

Adresa e kësaj shtëpie: _____

Numri i telefonit i kësaj shtëpie: _____

NUMRAT E EMERGJENCËS

POLICIA, ZJARRFIKËSJA ose AMBULANCA

Telefono 9-1-1

DËGJIMI I DËMTUAR

586-469-5093

Prindërit janë në këtë vend:

Adresa: _____

Telefoni: _____

Celulari: _____

Ata do të kthehen rreth orës _____ paradite/pasdite

Plani i Shtëpisë për Emergjencat ndodhet: _____

Kutia e Shtëpisë për Emergjencat ndodhet: _____

KUJTESË:

- Mos ia hapni derën askujt pa konfirmuar identitetin, qëllimin, dhe pa qenë të sigurtë që nuk përbëjnë rrezik
- Mbajini të gjitha dyert dhe dritaret të kyçura
- Dijeni gjithmonë se ku po luajnë fëmijët, qoftë brenda apo jashtë
- Kushtojini vëmendje njoftimeve për mot të keq dhe merrni masat e nevojshme

Shënime të Rëndësishme: _____



**SISTEMET
E PARALAJMËRIMIT
JASHTË SHTRËPISË**

SISTEMET E PARALAJMËRIMIT JASHTË SHTËPISË

Sirenat mund të aktivizohen për rrethanat e mëposhtme:

- Shërbimi Kombëtar i Motit ka dhënë një paralajmërim tornadoje për Kontenë Macomb për një periudhë specifike kohe ose vrojtuesit e trajnuar të motit kanë detektuar një tornado që po afrohet ose është brenda Kontesë Macomb.
- Stuhi të mëdha me erëra potenciale mbi 70 milje në orë ose me potencialin për të shkaktuar dëme të ngjashme me ato të një tornadoje.
- Një derdhje e një materiali të rrezikshëm që mund të ketë impakt mbi komunitetin dhe mund të kërkojë evakuim apo strehim në ndërtesën ku ndodheni aktualisht.

Sirenat e paralajmërimit jashtë shtëpisë kanë për qëllim t'ju njoftojnë në rast se një rrezik i menjëhershëm ka hyrë në komunitetin tuaj. Nuk duhet asnjëherë të supozoni se e dini cili është rreziku potencial kur dëgjohet një sirenë. Gjithmonë kërkonit menjëherë strehim dhe aksesoni çdo transmetim radioje e lajmesh për të përcaktuar natyrën e rrezikut dhe për të marrë udhëzime lidhur me sigurinë tuaj.

SISTEMET E PARALAJMËRIMEVE PËR MOTIN

Radiot personale të motit dhe aplikacionet personale të motit në telefonat celularë ju lejojnë akses të menjëhershëm në informacione që mund t'ju shpëtojnë jetën atëherë kur ka rëndësi çdo sekondë. Qofshi në shtëpi, në zyrë, apo duke udhëtuar, sistemet e paralajmërimit të motit të keq janë një vegël e dobishme për t'ju parapërgatitur ju dhe familjen tuaj për çdo emergjencë lidhur me motin.

NË SHTËPI

Mbajtja e një radioje moti brenda shtëpisë suaj mund t'ju paralajmërojë për çdo emergjencë të afërt lidhur me motin. Duke parë dhe dëgjuar lajmet e motit mund të krijoni një ide vizuale për sistemet e shkuara, të tashme dhe të ardhme të motit pranë jush.

NË PUNË

Nëse nuk mund të keni një radio moti, aplikacionet e motit në telefonin tuaj celular do t'ju ndihmojnë me çdo emergjencë moti me të cilën mund të përballeni në vendin e punës dhe mund t'ju ndihmojnë të përgatiteni për udhëtimin drejt shtëpisë.





**EVAKUIMI
DHE STREHIMI-
NË-VEND**

EVAKUIMI

Nëse ju kërkohet nga autoritetet të evakuoheni nga shtëpia apo vendi i punës, mund të keni në dispozicion vetëm disa minuta për t'u arratisur drejt një vendi të sigurtë dhe duhet të jeni të përgatitur të largoheni menjëherë pas njoftimit. Periudhat e evakuimit mund të zgjasin për disa orë apo ditë, në varësi të emergjencës, kështu që duhet të jeni të përgatitur për t'u kujdesur për veten dhe familjen tuaj për minimumi tre ditë.

Nëse ju thuhet të evakuoheni, ju lutem ndiqni këto këshilla të thjeshta:

- Ndizni radion ose televizorin dhe jini të përgatitur për t'i ndjekur të gjitha udhëzimet nga autoritetet e emergjencave
- Merrni kutinë e rezervave për emergjencat
- Kyçeni shtëpinë pasi të dilni
- Vendosni një shënim mbi derë për t'u treguar të tjerëve se ku keni shkuar. Policia lokale do të jetë duke patrulluar nëpër lagje
- Përdorni vetëm rrugët e udhëtimit që janë vënë në dispozicion nga autoritetet
- Zgjidhni një mik apo të afërm tek i cili do të shkoni, përpara evakuimit



Nëse keni kohë, përpiquni t'i kryeni këto punë të dobishme:

- Fikini të gjitha shërbimet e shtëpisë para se të largoheni (vetëm nëse dini si ta bëni këtë në mënyrë të sigurtë) Kontaktoni kompaninë e gazit kur të ktheheni për rifillimin e shërbimit

STREHIMI-NË-VEND

Ndonjëherë mund të jetë më e sigurtë të qëndroni aty ku jeni gjatë një emergjence sesa të evakuoheni. Nëse ju kërkohet nga autoritetet të "Strehoheni-në-Vend", ndiqni këto këshilla të dobishme:

- Mbyllini dhe kyçini të gjitha dritaret e dyert
- Fikini të gjithë ventilatorët dhe sistemet e ngrohjes e të kondicionimit të ajrit
- Mbylleni vatrën e zjarrit
- Fikeni të gjithë energjinë elektrike nëse e dini procedurën e saktë
- Në rastin e një stuhie të fortë, shkoni në bodrum ose në dhomën më të brendshme pa dritare
- Në rastin e një rreziku kimik, është më mirë një vend sipër tokës pasi shumica e kimikateve janë më të rënda se ajri dhe mund të futen në bodrum
- Ndizeni radion me bateri dhe dëgjoni udhëzimet e mëtejshme
- Sigurohuni që të bëni plane për evakuim nëse jepet një urdhër i tillë nga autoritetet e emergjencës





**KUR
NDODH NJË
RAST EMERGJENCE**

KUR NDODH NJË RAST EMERGJENCE

Gjatë një emergjence dhe pas saj, është e rëndësishme të qëndroni të qetë. Edhe pas një ngjarjeje, mund të ketë ende rreziqe. Ai që duket si vend i sigurtë mund të mos jetë i tillë. Qëndroni vazhdimisht të lidhur me televizionin e radion e emergjencave dhe stacionet e transmetimit dhe ndiqni këshillat e profesionistëve të trajnuar. Përveç rasteve kur ju thuhet të evakuoheni, shmangini rrugët në mënyrë që t'i lejoni automjetet e emergjencës të kalojnë lirshëm.

Gjatë një emergjence mund të mos keni akses në ushqim, ujë dhe elektricitet për një periudhë të zgjatur. Nëse nuk ka elektricitet, dyqanet ushqimore mund të jenë të mbyllura dhe sistemi i ujit mund të mos funksionojë. Ja disa sugjerime:

UJI

Nëse një emergjencë ju gjen pa rezerva uji, mund të përdorni kuba akulli dhe ujin në depozitën ose tubat e ujit të ngrohtë. Nëse nuk ka problem të dilni jashtë, mundeni gjithashtu ta purifikoni ujin nga përrenjtë ose lumenjtë, uji i shiut, pellgjet e liqenet, burimet natyrale dhe dëbora duke e zier (për 5 minuta), distiluar apo dizinfektuar. Për ta purifikuar ujin me klor, përdorni 10 pika klor për një gallon ujë. Përdorni vetëm klor të lëngshëm që përdoret zakonisht në shtëpi, i cili përmban vetëm 5.25% hipoklorit natriumi.

USHQIMI

Gjatë një emergjence dhe menjëherë pas saj, është e rëndësishme që ta ruani forcën duke ngrënë të paktën një vakt të mirë-balancuar çdo ditë. Merrni suplemente vitaminash, mineralesh dhe/ose proteinash.


NËSE NDËRPRITET ELEKTRICITETI

- Rrini të qetë, dhe ndihmoni familjarët apo fqinjët që mund të kenë probleme po të ekspozohen ndaj të nxehtit apo të ftohtit ekstrem.
- Gjeni një elektrik dore me bateri për ta përdorur derisa të vijë prapë elektriciteti. Mos përdorni qirinj (kjo mund të shkaktojë zjarr)
- Fikini pajisjet elektrike delikate si kompjuterët, DVD player-at, dhe televizorët
- Fikini pajisjet e mëdha elektrike që ishin të ndezura kur iku elektriciteti. Kjo do të ndihmojë në parandalimin e tensionit të lartë kur të rikthehet elektriciteti
- Mbajini dyert e frigoriferit dhe ngrirësit të mbyllura sa më mirë që të mundeni për ta mbajtur të ftohtin brenda dhe të nxehtin jashtë
- Mos e përdorni sobën për të ngrohur shtëpinë -- kjo mund të shkaktojë zjarr ose dalje fatale gazi
- Përdorni kujdes të jashtëzakonshëm kur udhëtoni me makinë. Nëse sinjalet e trafikut nuk punojnë, trajtojeni çdo sinjal si shenjë ndalimi -- ndaloni plotësisht në çdo kryqëzim dhe kontrolloni përpara se të vazhdoni rrugën
- Mos i telefononi numrit 911 për të pyetur rreth ndërprerjes së energjisë. Dëgjojini lajmet në radio për të marrë informacione

NËSE KENI KAFSHË SHTËPIAKE

Krijoni një kuti mbijetese për kafshën tuaj. Kjo duhet të përfshijë:

- Qaforen e identifikimit dhe etiketën e sëmundjes së tërbimit
- Mbajtësen apo kafazin
- Rripin
- Ndonjë ilaç (mos harroni t'i kontrolloni datat e skadimit)
- Gazeta dhe qese plastike plehrash për jashtëqitjet
- Rezerva ushqimi, uji, dhe tasash ushqimi për të paktën dy javë
- Dokumentet veterinare (shumica e strehëve për kafshët nuk i lejojnë kafshët pa vërtetim vaksinimi)



GJATË DURING

BE READY! FLOODS JINI NË GATISHMËRI! PËRMBYTJET


Hiqini pajisjet nga priza për të parandaluar një shok elektrik kur të rikthehet elektriciteti.

MOS ngisni makinën dhe mos ecni në rrugë të përmytura. Uji mund t'i marrë me vete makinat dhe njerëzit.

Mblidhni rezervat e emergjencës dhe ndiqni njoftimet e radiove apo televizioneve lokale.

PARALAJMËRIME PËR MOTIN

NJIHUNI ME RREZIQET E PËRMBYTJEVE



- Identifikoni zonat pranë jush që kanë tendencën të përmyten apo ku mund të ketë rreshqitje dheu.

- Jini në dijeni të sinjaleve të paralajmërimit, shtigjeve të evakuimit, dhe vendndodhjeve të strehimeve të emergjencës në komunitetin tuaj.

- Jini në dijeni të shtigjeve të evakuimit në rast përmytjeje pranë jush.

Kur nuk ka elektricitet, ju ka hyrë uji në shtëpi, apo para se të evakoheni, FIKINI gazin, elektricitetin dhe ujin.


Lidhini ose futini brenda sendet që ndodhen jashtë shtëpisë.

Hidhni sendet që nuk mund të dezinfektohen, si veshjet e murit, stofrat, qilimat dhe pllakat e gipsit në mure.

PRAKTIKONI HIGJENË TË MIRË



Lajini duart me sapun dhe ujë për të parandaluar mikrobet.



Dëgjoni informacionet e zyrtarëve lokalë se si ta përdorni ujin pa rrezik për të pirë, gatuar apo pastruar.

PAS AFTER

Përdorni ventilatorë, kondicionerë ajri, dhe pajisje... për heqjen e lagështisë, për tharje.

Gjatë pastrimit, vishni çizme gome dhe doreza plastike.

Pastrojini muret, dyshemetë e forta dhe sipërfaqet e tjera me ujë e sapun. Përdorni një përzierje prej 1 kupë zbardhues dhe 1 gallon ujë për dezinfektim.

Kujdes! Uji i përmytjeve mund të përmbajë plehra.



Për më shumë informacion, vizitoni <http://emergency.cdc.gov/disasters/floods/>

RIKUPERIMI NGA NJË FATKEQËSI/EMERGJENCË

Qëndroni të lidhur me radion apo televizionin lokal për të marrë informacione dhe udhëzime lidhur me emergjencat.

Faza e rikuperimit mund të jetë aspekti i një fatkeqësie/emergjence që kërkon më shumë kohë. Marrja e hapave të duhur përpara dhe pas një fatkeqësie/emergjence do t'ju ndihmojë për një rikuperim të shpejtë dhe të efektshëm. Një mënyrë për të ndihmuar në këtë proces është që të gjithë banorët të kenë sigurim aktual dhe të duhur të pronës. Udhëzimet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë në procesin e rikuperimit.

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- Kontaktojeni kompaninë tuaj të sigurimit sa më shpejt të jetë e mundur për të nisur procesin e rimbursimit.
- Ruajini faturat e të gjitha shpenzimeve që bëni pas fatkeqësisë/emergjencës. Këto janë të rëndësishme për kërkesa të ardhshme që mund të bëni lidhur me sigurimet dhe taksën mbi të ardhurat.
- Jini në dijeni të rreziqeve lidhur me shërbimet e shtëpisë (uji, elektriciteti, etj.), dhe mos provoni asnjëherë t'i ndizni apo fikni ato vetë.
- Kontaktoni Kryqin e Kuq Amerikan (313) 833-8816 ose Ushtrinë e Shpëtimit (888) 803-885 nëse keni nevojë për ushqim, veshje apo strehim të përkohshëm.

TORNADO

- Bëni kujdes kur hyni në një ndërtesë, duke u siguruar që muret, tavani dhe çatia të jenë në vend dhe të sigurta në themele.
- Jini në dijeni të linjave të dëmtuara të gazit natyral. Era e gazit apo zhurma fërshëllyese janë shenja që tregojnë se linjat e gazit natyral mund të jenë të dëmtuara. Nëse ndjeni ndonjëherë prej këtyre shenjave hapini dritaret për ta ventiluar shtëpinë dhe largohuni menjëherë. Mos pini duhan, mos përdorni fenerë me vaj ose gaz apo qirinj për të ndriçuar shtëpinë derisa një gjë e tillë mos të shkaktojë rrezik.
- Bëni kujdes nga shkëndijat, telat e thyer apo të zhveshur; elektriciteti mund të jetë funksional dhe telat e ekspozuar mund të përçojnë elektricitet. Nëse zona është e pasigurt largohuni dhe kërkonin ndihmë.

ZJARRI

- Hidhni tej të gjitha ushqimet, pijet dhe ilaçet që janë ekspozuar ndaj nxehtësisë, tymit apo blözës.
- Mos e hapni një kasafortë të mbrojtur nga zjarri deri kur të ftohet.

MOTI I DIMRIT

- Nëse ju duhet të dilni jashtë, ecni me kujdes mbi borë dhe akull me këpucë të përshtatshme.
- Bëni kujdes kur hiqni dëborën me lopatë, lodhja e tepërt mund të shkaktojë atak në zemër. Për të qenë të sigurt bëni pushime dhe shtyjeni borën e mos e ngrini lart.
- Bëni kujdes ndaj shenjave të para të sëmundjeve të ftohtit, të cilat përfshijnë humbjen e ndjesisë dhe zbardhim të ekstremiteteve (p.sh. Gishtat e duarve, të këmbëve, hunda).
- Jini në dijeni të simptomave të hipotermisë, të cilat përfshijnë dridhje të pakontrollueshme, humbje të kujtesës, inkoherencë, përgjumje, dhe lodhje të madhe.
- Udhëtoni me makinë vetëm kur është absolutisht e nevojshme, dhe kur e bëni këtë, mos udhëtoni vetëm dhe udhëtoni në rrugët kryesore.
- Nëse shtëpia juaj humbet elektricitetin apo ngrohjen për shkak të një stuhie, duhet të kërkonin strehim në një strehë publike. Këto mund të gjenden duke kontaktuar Kryqin e Kuq Amerikan (313) 833-8816 ose Ushtrinë e Shpëtimit (888)-803-8858.





PËRMBYTJET

- Kurrë mos hyni në një ndërtesë nëse ujërat e përmbytjes mblidhen përreth ndërtesës.
- Derdheni ushqimin dhe ujin që ka qenë në kontakt me ujërat e përmbytjes.
- Nxirreni ngadalë ujin me pompë nga bodrumet e përmbytura, rreth një të tretën e ujit në ditë, për ta mbrojtur themelin nga dëme të mëtejshme.
- Thirrni menjëherë dikë për t'u bërë shërbim rezervuarëve septike, gropave të ujërave të zeza dhe sistemeve të kullimit.
- Sistemet e dëmtuara të ujërave të zeza janë rrezik për shëndetin dhe mund t'i intensifikojnë efektet e përmbytjes.

INCIDENTET E MATERIALEVE TË RREZIKSHME

- Nëse jeni evakuar, mos u ktheni në shtëpi deri kur autoritetet lokale të thonë se nuk ka më rrezik.
- Kur të mbërrini në shtëpi, hapini të gjitha dritaret dhe dyert për ventilim natyral.
- Mos provoni ventilim mekanik (ventilatorë elektrikë), pasi ata mund të shkaktojnë një rrezik shpërthyes.
- Mësoni nga autoritetet lokale se si ta pastroni tokën dhe pronën tuaj.
- Hidhni ushqimet dhe ujin që janë kontaminuar nga materiali i rrezikshëm.

Nëse keni pyetje lidhur me praktikën e sigurisë, kthimin në shtëpi pas një ngjarjeje, apo se si të përgatiteni për një emergjencë, telefonojini Komunikimeve & Menaxhimit të Emergjencave në Kontenë Macomb në numrin (586) 469-5270. Nëse keni pyetje lidhur me sigurinë e ushqimeve dhe ujit tuaj të pijshëm, kontaktoni me Departamentin e Shëndetit të Kontesë Macomb në numrin (586) 469-5236.



8 SHENJA TË TERRORIZMIT

#1 Survejimi

Dikush që regjistron apo monitoron veprimtaritë. Kjo mund të përfshijë përdorimin e kamerave (të palëvizshme ose video), marrjen e shënimeve, vizatimin e diagramave, shënime mbi harta, ose përdorimin e dylbive apo pajisjeve të tjera që përmirësojnë shikimin.

#2 Mbledhja e informacionit

Njerëz apo organizata që përpiqen të marrin informacione lidhur me zbatimin e ligjit dhe/ose operacionet, kapacitetet, apo personat ushtarakë. Përpjekjet e mbledhjes së informacionit mund të bëhen me anë të postës, fax-it, telefonit, ose nga vetë personi.

#3 Testet e Sigurisë

Çdo përpjekje për të matur kohën e reagimit ndaj thyerjeve të sigurisë ose për të depërtuar barrierat fizike apo procedurat e sigurisë në mënyrë që të vlerësojë pikat e forta dhe të dobëta.

#4 Sigurimi i Mjeteve

Blerja apo vjedhja e eksplozivëve, armëve, municioneve, etj. Përfshin sigurimin e uniformave ushtarake, stemave, manualeve të fluturimit, leje-kalimeve apo distinktivëve (ose të pajisjeve për prodhimin e sendeve të tilla), apo të sendeve të tjera të kontrolluara.

#5 Persona të Dyshimtë që Nuk i Përkasin Vendit

Njerëz që nuk duket se i përkasin vendit të punës, lagjes, ndërtesës së biznesit, apo një vendi tjetër. Përfshin kalime të dyshimta të kufirit dhe udhëtarë pa bileta në anije ose njerëz që kërcejnë nga anija në port.



#6 Prova/Testime

Vendosja e njerëzve në pozicion dhe lëvizja e tyre sipas planit pa e kryer në të vërtetë aktin terrorist. Kjo ndodh sidomos kur planifikohet një rrëmbim, por mund të bëhet edhe në raste bombash. Një element i kësaj veprimtarie mund të përfshijë gjithashtu hartimin e rrugëve dhe përcaktimin e kohës së semaforëve dhe rrjedhës së trafikut.

#7 Mobilizimi i Aseteve

Njerëz dhe mjete vendosen në pozicion për të kryer aktin. Ky është shansi i fundi për t'i lajmëruar autoritetet para se të ndodhë akti terrorist.

#8 Financimi

Transaksionet e dyshimta që përfshijnë pagesa të mëdha me para kesh, depozita, ose tërheqje janë shenja të zakonshme të financimit terrorist. Mbledhjet për donacione, kërkesat për para dhe veprimtaritë kriminale janë gjithashtu shenja paralajmëruese.



PARAPËRGATITJA PËR NJË SULM TERRORIST

Që nga sulmet e 11 shtatorit 2001, kërcënimet terroriste ndaj Shteteve të Bashkuara janë bërë më të shpeshta. Grupe dhe individë ekstremistë punojnë për të siguruar armë kimike, biologjike, eksplozive, radiologjike, dhe bërthamore. Profesionistët e sigurisë publike në Kontenë Macomb, si dhe në mbarë shtetin e Michigan dhe në Shtetet e Bashkuara po punojnë për forcimin e sigurisë së vendit tonë.

Të gjitha emergjencat fillojnë lokalisht, dhe terrorizmi nuk bën ndryshim. është e nevojshme që të gjithë qytetarët t'i njohin dhe t'i kuptojnë kërcënimet potenciale dhe se si duhet të përgatiten për to. Ndonëse është e pamundur të parashikohet se si do të ndodhë një incident, ekzistojnë gjëra të thjeshta që mund të bëjmë për të mbrojtur veten dhe njerëzit tanë.

SULMET KIMIKE DHE BIOLOGJIKE

Ka mundësi që publiku të bjerë në kontakt me një agjent kimik dhe/ose biologjik, qoftë rastësisht apo qëllimisht. Efekti i agjentëve kimikë ose biologjikë nuk do të jetë gjithmonë i dukshëm menjëherë, nisur nga fakti se shumë agjentë të tillë janë pa ngjyrë dhe pa erë.

TREGUESIT

- Pika të një shtrese të yndyrshme mbi sipërfaqe të ndryshme
- Kafshë të vdekura apo duke vdekur në zonë
- Aroma të pashpjegueshme
- Simptoma të pështjelli, vështirësi në frymëmarrje, konvulsione, çorientim
- Formacione të ulëta resh ose mjegull që nuk ka lidhje me motin aktual, re pluhuri; ose thërmija që rrinë pezull, mundësisht me ngjyrë

HAPAT QË DUHEN MARRË

- Lëvizni në drejtim të kundërt me burimin e sulmit
- Nëse evakuimi nuk është i mundur, futuni brenda në ndërtesë dhe aplikoni Strehimin-Në-Vend (Shihni faqen 18).
- Vini një maskë gazi, ose nëse nuk ju gjenden pranë maska të tilla, mbuloni gojën dhe hundën me një copë të pastër të lagur në një përzierje me një kupë ujë dhe një lugë sodë buke tryeze.
- Gjithashtu mbulojeni lëkurën e zhveshur dhe sigurohuni që t'i mbuloni prerjet dhe gërvishtjet.
- Nëse ekspozoheni, hiqini rrobat dhe mbyllini në një qese plastike, lahuni menjëherë duke përdorur sasi shumë të mëdha uji të ngrohtë me sapun ose përzierje klori të holluar në raportin 10:1.
- Gjithmonë kërkoni kujdes mjekësor sa më shpejt të jetë e mundur pas rënies në kontakt me një agjent kimik apo biologjik.

Nëse ndodh një ngjarje kimike apo biologjike, qëndroni të lidhur me stacionet lokale të radios dhe televizionit për t'u përditësuar mbi situatën dhe udhëzimet e parapërgatitjes dhe/ose të përgjigjes.

PARAPËRGATITJA PËR NJË SULM TERRORIST

SULMET EKSPLOZIVE

Pajisjet eksplozive janë forma më e rëndomtë e sulmeve terroriste; për shkak të lehtësisë së gjetjes së informacionit, dhe lehtësisë së detonimit. Njohuria e mirë lidhur me mjedisin tuaj do t'ju ndihmojë për të qenë vigjilent në rastin e një incidenti të tillë.

HAPAT QË DUHEN MARRË

- Nëse dyshoni se ka një pajisje shpërthyes që do të shpërthejë, largohuni menjëherë nga zona.
- Telefoni numrit 9-1-1 kur kjo gjë të jetë pa rrezik, dhe ndajini shqetësimet tuaja me operatorin.
- Dëgjojeni sistemet lokale, shtetërore dhe federale të lajmërimit për emergjencat (TV, radio, etj.) për udhëzime.
- Nëse një pajisje shpërthen, kontrolloni veten dhe njerëzit rreth jush për ndonjë plagë, dhe nëse është pa rrezik, kujdesuni për këto plagë.

SULMET BËRTHAMORE DHE RADIOLOGJIKE

Një sulm bërthamor është përdorimi i një pajisjeje që prodhon një shpërthim bërthamor i cili shkakton një valë të fortë nxehtësie, drite, presioni ajror, dhe rrezatimi. Një sulm radiologjik është përhapja e një materiali radiologjik me qëllimin për të shkaktuar dëme, me anë të një pajisjeje konvencionale shpërthyes. Në rastin e një sulmi bërthamor apo radiologjik, dëgjojeni autoritetet lokale, shtetërore ose federale për udhëzimet e duhura. Strehimi-në-Vend dhe evakuimi janë masat parësore që ndërmerren në rastin e një sulmi bërthamor apo radiologjik (Shihni faqen 18). Tre konceptet kryesore për ta mbrojtur veten nga ekspozimi ndaj rrezatimit janë koha, distanca, dhe mbrojtja.

- **Koha:** Ulja e sasisë së kohës që kalohet në zonën e ekspozimit.
- **Distanca:** Rritja e distancës tuaj nga burimi i rrezatimit.
- **Mbrojtja:** Krijimi i një barriere midis jush dhe burimit të rrezatimit.

HAPAT QË DUHEN MARRË

- Dëgjojeni sistemet lokale, shtetërore dhe federale të lajmërimit për emergjencat (TV, radio, etj.) për udhëzime.
- Merrni masat sipas udhëzimeve, të cilat mund të përfshijnë strehim-në-vend ose evakuim (Shihni faqen 18).
- Mbuloni gojën dhe hundën me një copë të lagur për t'iu shmangur thithjes së materialeve radiologjike.
- Hiqini rrobat e kontaminuara sa më shpejt të mundeni; vendosini ato në një kontenier të mbyllur.
- Lajeni butësisht lëkurën për të hequr kontaminimin e mundshëm.
- Sigurohuni që të mos futni gjë përmes gojës, për shembull: ngrënie, pirje, tymosje.





**SULMUESIT
AKTIVË**

PARAPËRGATITJA PËR NJË SULMUES AKTIV

Ngjarjet e kohëve të fundit në Shtetet e Bashkuara kanë treguar se sulmuesit aktivë mund të ndodhin në çdo vend e në çdo kohë. Në mënyrë që të ruani veten, familjarët dhe komunitetin tuaj, ju lutem rishikojini këto praktika që këshillohen para, gjatë dhe pas incidenteve të tilla. Marrja e hapave të duhur tani mund t'ju ndihmojë të merrni masa atëherë kur koha është e kufizuar.

PËRGATITJA PËRPARA

- Njoftojini autoritetet menjëherë nëse shihni diçka të dyshimtë.
- Familjarizohuni me planet kundër sulmuesve aktivë për vendet që vizitoni rregullisht (p.sh. puna, objektet fetare, etj.) Kërkoni të merrni pjesë në stërvitje apo trajnime.
- Kur vizitoni ndërtesa të mëdha e të hapura si qendrat tregtare apo objektet e kujdesit shëndetësor, identifikoni dy dalje të afëta. Bëjeni rëndom këtë gjë; mund ta ktheni madje edhe në lojë.
- Merrni kohën e nevojshme për të gjetur vende fshehjeje në çdo mjedis. Këto vende mund të përfshijnë dhoma me dyer e kyçe që mbyllen mirë, dhoma pa dritare, dhe dhoma me mobilie të rënda.
- Regjistrohuni në trajnime për mbrojtjen ndaj sulmuesve aktivë dhe për dhënien e ndihmës së shpejtë.

GJATË

- **Vraponi** – Prioriteti kryesor është të ikni sa më larg incidentit. Mos ndaloni të mblidhni sendet vetjake, dhe nëse keni mundësi, paralajmëroni të tjerët teksa ikni. Lajmëroni autoritetet kur mund ta bëni këtë pa rrezik.
- **Fshihuni** – Nëse nuk ka asnjë mundësi për t'u arratisur apo për të vrapuar, gjeni një vend të sigurtë për t'u fshehur. Rrini diku që sulmuesi mos t'ju shohë dhe përpiquni të gjeni një dhomë me dyer të mira dhe me kyç, pa dritare, dhe me mobilie të rënda. Heshtini pajisjet elektronike dhe lajmërojini autoritetet me anë të metodave të heshtura; kjo mund të përfshijë mesazhe në celular ose shenja nga një derë/dritare. Mos ia hapni derën askujt deri sa autoritetet t'ju konfirmojnë që nuk ka më rrezik.
- **Luftoni** – Kur është e domosdoshme dhe jeni në rrezik të papritur, mbrojeni veten. Aksioni agresiv dhe i shpejtë është mënyra më e mirë për ta ndalur personin që do të qëllojë me armë. Mund ta shpërqendroni dhe ta pengoni atë duke i zënë pritë me sende si karriget, fikëset e zjarrit, dhe librat.

PAS

- Mbajini duart të dukshme dhe bosh.
- Detyra kryesore e forcave të zbatimit të ligjit është të eliminojnë kërcënimin; ata mund të mos ndalojnë të japin ndihmë.
- Ndiqini të gjitha udhëzimet e forcave të zbatimit të ligjit.
- Konsideroni ndihmën profesionale për ju dhe familjen për t'ju ndihmuar në shërimin nga kjo ngjarje traumatike.





**T'I TELEFONOSH
NUMRIT 9-1-1**

TELEFONOJINI NUMRIT 9-1-1

Një telefonatë në numrin 9-1-1 është mënyra më e efektshme për t'i lajmëruar autoritetet për raste emergjencash apo fatkeqësish.

TEKST NË NUMRIN 9 - 1 - 1

Tekst-në- 9-1-1 është mundësia të dërgoni një mesazh tekst për të kontaktuar me operatorët e emergjencave nga celulari juaj.

Megjithatë, meqë tekst-në-9-1-1 aktualisht funksionon vetëm në disa vende të caktuara, duhet gjithmonë të bëni një telefonatë për të kontaktuar me 9-1-1 gjatë një emergjence sa herë që të keni mundësi.

SMART 9 - 1 - 1

Smart911 u lejon qytetarëve të japin detaje shitesë që mund t'u duhen operatorëve të 9-1-1 për të ndihmuar gjatë një emergjence. Këto detaje mund të përfshijnë: informacion mbi personin dhe shtëpinë, informacion mjekësore, info mbi adresën dhe vendndodhjen dhe çdo gjë tjetër që dëshironi ta dinë operatorët. Për më shumë informacion vizitoni www.smart911.com

Të disponueshme përmes Smart911:

PROFILI I SIGURISË

Jepni informacione shitesë për 9-1-1 në mënyrë që ata të mund t'ju ndihmojnë më shpejt në një rast emergjence.

ALERTET DHE NJOFTIMET

Informohuni vazhdimisht rreth emergjencave lidhur me motin, trafikun, etj në komunitetin tuaj.

REGJISTRI I NEVOJAVE TË VEÇANTA

Njoftojini menaxherët e emergjencave që keni nevojë për ndihmë të veçantë në rast fatkeqësie.





Emergency
Management

FALEMINDERIT QË E LEXUAT KËTË MANUAL

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutem kontaktoni Komunikimet & Menaxhimi i Emergjencave në Kontenë Macomb në numrin 586-469-5270 ose vizitoni mcoem.MacombGov.org



Emergency
Management

Komunikimet & Menaxhimi i Emergjencave • (586) 469-5270 • mcoem.macombgov.org